



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1251/ 7 prot.

Datë 03.06.2025

V E N D I M

Nr. 738/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2025 me:

Objekt:

Mbi verifikimin e dokumentacionit kualifikues, në mbështetje të vetëdeklarimeve të paraqitura nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-34415-12-23-2024 me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
Adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. Nr. 88, H.1,
1023, Tiranë

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NUIS L52122014L, me adresë: Rruga “Siri Kodra”, Ish Blloku i Magazinave të Tregtis, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

V ë r e n:**I**

I.1. Në datën 24.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-34415-12-23-2024 me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energji se Elektrike Group sh.a.

I.2. Në datën 25.03.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

I.3. Refreuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Adel Co” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
2. “Filara” SHPK	12.730.260 lekë	kualifikuar
3. “Inpress” SHPK	16,133,000 lekë	kualifikuar
4. “Kristalina” SHPK	16,387,700 lekë	kualifikuar
5. “Marketing & Distribution” SHPK	16,517,100 lekë	kualifikuar
6. “Dynamicx Group” SHPK	17,841,300 lekë	kualifikuar
7. “Infosoft Office” SHPK	18,599,665 lekë	kualifikuar
8. “Albdesign PSP” SHPK	19,522,800 lekë	kualifikuar
9. “Olsoni” SHPK	20,731,500 lekë	kualifikuar

I.4. Në datën 08.05.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “Filara” SHPK.

I.5. Në datën 14.05.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1251/2025 protokoli, dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5308 e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-34415-12-23-2024 me objekt: *“Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”*, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK dhe “Filara” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1251/1 prot., datë 14.05.2025, me pretendimet e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, i cili kundërshton kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK dhe “Filara” me anë të ankesës me nr. 1251/2025 prot., datë 14.05.2025, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

I.5.2. Më datë 19.05.2025, operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur Formularin e Paraqitjes së Argumentave, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike protokolluar pranë KKP-së, me nr. 1251/2 prot., datë 19.05.2025.

I.5.3. Më datë 20.05.2025, operatori ekonomik “Filara” SHPK ka paraqitur Formularin e Paraqitjes së Argumentave, nëpërmjet shërbimit postar protokolluar pranë KKP-së, me nr. 1251/3 prot., datë 21.05.2025.

I.5.4. Nëpërmjet shkresës nr. 4712/2 prot., datë 26.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1251/4 prot., datë 26.05.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Referuar informacionit dhe dokumentacionit sa më sipër,

Arsyeton

II.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” Shpk, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi për mospërbushje të kriterëve të kualifikimit sipas formularit të publikimit nr. 1251/1 datë 14.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.2. Në dokumentet standarde të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

2.3.5. *Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do te jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

- ***Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me përmasa më të mëdha***
- ***Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit***
- *Makinë qepse me pe me permasa 35x25*
- *Makinë prerje me permasa 80x110*
- *Makine qepese me tel*
- *Thikë një anëshe*
- *Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.*
- *Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji).*
- ***Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të permbajë të dhena të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.***

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne rast se do te jete vete prodhues.

Sqarim : *përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

- *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera*

shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

II.3. Në nenin 24 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.

2. Komisioni i Prokurimit Publik është person juridik publik, i pavarur, që financohet nga buxheti i shtetit dhe i raporton Kuvendit.

3. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

Ndërsa në nenin 82, *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*, pika 2 dhe 5, po këtui, thuhet se: “[...] 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.” [...] 5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre; b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

II.4. Në nenin 115 “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik”, pika 1, gërma “c” të LPP-së, parashikohet si vijon: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: [...] c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.”

II.5. Në nenin 30 “Kompetencat e hetimit”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet:

“1. Komisioni heton të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha provat e paraqitura për zgjidhjen e çështjes duke përcaktuar në mënyrë të pavarur shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson kryesisht nëse një fakt apo një rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Kur gjatë gjatë shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik konsideron nevojën e provave/ekspertizave, kryesisht ka të drejtë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta, apo të kryejë verifikime pranë organeve të tjera.”

II.6. Referuar pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK për kapacitetet e ofruara nga “Inpress” SHPK, në përmbushje të kriterëve kualifikuese të veçanta, në procedurën e prokurimit objekt ankimi (me ankesën e dorëzuar në Sistemin Elektronik të Ankesave) dhe duke qenë se ky verifikim nuk mund të kryhet nga KPP në institucionet përkatëse, ose në bazën e të dhënave shtetërore, për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkon:

- Operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për verifikim, dokumentacionin origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, lidhur me plotësimin e kërkesave të autoritetit kontraktor, konkretisht kriterin 2.3.5 të modifikuar si më sipër cituar, në përputhje me nenet 82 dhe 115 të LPP-së i ndryshuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 24 e në vijim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar të tyre, nga ana e operatorit ekonomik “Inpress” Shpk, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-34415-12-23-2024 me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.
2. Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 12.06.2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

